

VENDIM
Nr. 15, datë 22.4.2015

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË “UK SARANDË
SHA”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR nr. 22, datë 14.11.2014, “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë UK Sarandë sh.a:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	52 lekë/m ³	20 lekë/m ³
Institucione buxhetore	138lekë/m ³	31 lekë/m ³
Ente private	138lekë/m ³	31 lekë/m ³

b) Tarifë fikse

Konsumator familjar	150 lekë/muaj/klient
Institucione buxhetore	150 lekë/muaj/klient
Ente private	150 lekë/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Perfor-mancës për vitin 2015:

- uji pa të ardhura (humbjet) 60%
- niveli i matjes 80%
- kohëzgjatja e furnizimi 8 orë/ditë
- efienca e energjisë 0.68 kwh/m³
- efikasiteti i stafit 3.33 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 97%
- mbulimi me kanalizime 76%
- norma e arkëtimit 85%
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standar-deve

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr. 49, datë 30.12.2013 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. “UK Sarandë”” shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.5.2015 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi